



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

**VENDIM**

Nr.12, datë 04.02.2021

**PËR**

**STREHIMIN E FAMILJES SË ZJ. ANILA BANUSH YMERI NË APARTAMENTIN ME SIPËRFAQE 50,21 M<sup>2</sup>, ME STRUKTURË (1+1), ME NR. PASURIE 2/130-1-10, ZONA KADASTRALE 8513, LAGJA NR.5, RRUGA"TEODOR RUPI" NR.21, DURRËS, PRONË E DHURUAR ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE SIPAS MARRËVESHJES NËNSHKRUAR MIDIS ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE DHE "BALFIN" SHPK, NR. 148 PROT., DATË 22.01.2020, NË KUADËR TË PROÇESIT TË RINDËRTIMIT**

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.11, datë 12.03.2020 "Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet e procesit të rindërtimit për strehim", procesverbalit të hartuar nga Komisioni i Strehimit dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve në bashkëpunim me Komisionin e Strehimit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e strehimit të familjes së zj. Anila Banush Ymeri, në apartamentin me sipërfaqe 50,21 m<sup>2</sup>, me strukturë (1+1), me nr. pasurie 2/130-1-10, zona kadastrale 8513, lagja nr.5, rruga"Teodor Rupi" nr.21, Durrës, pronë e dhuruar Entit Kombëtar të Banesave sipas

marrëveshjes nënshkruar midis Entit Kombëtar të Banesave dhe “Balfin” shpk, me nr. 148 prot., datë 22.01.2020, në kuadër të procesit të rindërtimit.

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të bashkëpunojë me Entin Kombëtar të Banesave në zbatim të Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 dhe legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Durrës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 04.02.2021**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PRËFЕКTI I QARKUT DURRËS

Nr. 106/prot.

3



Durrës, më 11.02.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 12 datë 04.02.2021 “Për strehimin e familjes së zj. Anila Banush Ymeri në apartamentin me sipërfaqe 50,21 m<sup>2</sup>, me strukturë (1+1), me nr. pasurie 2/130-1-10, zona kadastrale 8513, lagja nr.5, rruga”Teodor Rupi” nr 21, Durrës, pronë e dhuruar Entit Kombëtar të Banesave sipas marrëveshjes nënshkruar midis Entit Kombëtar të Banesave dhe “Balfin” shpk, nr. 148 prot., datë 22.01.2020, në kuadër të procesit të rindërtimit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

